




FUQIZIMI I FAMILJEVE IMIGRANTE: UDHËZUESI JUAJ I ADVOKIMIT

Udhëzues burimor për imigrantët dhe
familjet shumëgjuhëshe në NYC Public Schools
(Shkollat Publike të Nju-Jorkut)



Qershor 2024

Fuqizimi i Familjeve Imigrante



Tabela e PËRMBAJTJES

Faqe

03

Hyrje

- Përmbledhje dhe qëllimi i udhëzuesit burimor.
- Falënderime nga NYC Public Schools' Division of Multilingual Learners (Sektori për Nxënësit Shumëgjuhësh i Shkollave Publike të NYC-së) dhe UndocuTeacher.

05

Kuptimi i Fuqisë dhe Aftësisë për të Vepruar

- Përkufizimi i fuqisë dhe aftësisë për të vepruar në kontekstin e familjeve imigrante dhe shumëgjuhëshe.
- Hapat drejt advokimit për familjet imigrante.

06

Hapi 1: Zgjeroni Njohuritë dhe Ndërgjegjësohuni

- Politikat dhe të drejtat që ndikojnë te nxënësit imigrantë dhe shumëgjuhësh në shkolla
 - Terminologjia, të drejtat dhe politikat e imigracionit
 - Aksesit gjuhësor
 - Arsimit i lartë
 - Familjet në strehim të përkohshëm

13

Hapi 2: Ushtroni Aftësinë për të Vepruar përmes Angazhimit

- Strategji për komunikim efektiv me edukatorët.
- Mundësitë për përfshirjen e prindërve dhe familjeve në proceset vendimmarrëse të shkollës.
- Nxitja e kompetencës kulturore dhe përfshirjes në shkollën tuaj.

17

Hapi 3: Aksesoni Burime për t'u Fuqizuar

- Burimet për familjet imigrante: akses gjuhësor, ndihmë ligjore, kërkim i organizatave me bazë komunitare dhe shumë të tjera.
- Vizualizimi i angazhimit të familjes.
- Fletë pune për suksesin e angazhimit të familjes.

20

Raste Studimore dhe Histori Suksesi

- Shembuj të familjeve imigrante dhe shumëgjuhëshe që arrijnë me sukses të ushtrojnë fuqinë dhe aftësinë për të vepruar brenda NYCPS.
- Mësimet e nxjerra dhe praktikatat më të mira nga këto përvoja.

21

Përfundime

- Letër drejtuar të gjitha familjeve imigrante.

Hyrje

askush nuk e braktis shtëpinë,
nga shtëpia ikën vetëm kur ajo
është goja e peshkaqenit
ti vrapon drejt kufijve vetëm
kur sheh të gjithë qytetin duke vrapuar....

duhet të kuptosh, askush nuk e fut fëmijën
në anije përpos atëherë kur uji është më
i sigurt se toka

Përmbledhja dhe qëllimi i këtij udhëzuesi burimor

Ky fragment nga poezia “Home” (Shtëpia) e Warsan Shire ngjall përvojën e largimit nga shtëpia që përjetojnë shumë familje imigrante, një udhëtim që kërkon guxim të madh për të gjetur siguri, mundësi dhe përparim.

Familjet imigrante lundrojnë në mjedise të panjohura, shpesh duke u ndeshur me diskriminim, pengesa sistemike dhe sfida të tjera, ndërkohë që përpiqen të krijojnë një ndjenjë shtëpie dhe një të ardhme për fëmijët e tyre. Përmes veprimeve dhe sakrificave të tyre, familjet imigrante luajnë rol jetik në formësimin e identitetit dhe përvojave të fëmijëve të tyre, duke nxjerrë në pah fuqinë dhe aftësinë për të vepruar në kontekstin më të gjerë të migrimit dhe përkatësisë.

Në këtë udhëzues, synojmë të nderojmë sakrificat e bëra nga familjet imigrante dhe të pranojmë fuqinë e tyre të lindur për të ndërtuar një shtëpi për veten dhe fëmijët e tyre. Ne nderojmë diversitetin e tyre personal, kulturor dhe gjuhësor si pasuri dhe mjete të domosdoshme që u japin mundësinë familjeve të jenë aktorë të ndryshimit, lidershit dhe advokimit në jetën akademike të fëmijëve të tyre, pavarësisht nga statusi i tyre i imigrimit. Ne e pranojmë se angazhimi i familjes mbështet suksesin akademik në përgjithësi dhe ndjenjën e përkatësisë të nxënësit.

Ftojme të gjithë anëtarët e familjeve në New York City Public Schools (Shkollat Publike të Nju-Jorkut) të përdorin këtë udhëzues për të mësuar se çfarë do të thotë të jesh pjesëmarrës aktiv dhe udhëheqës në rrugëtimin akademik të fëmijës suaj. Në këtë udhëzues do të merrni njohuri mbi të drejtat tuaja si familje imigrante, do të mësoni për mënyrat e ndryshme se si të përfshihen në shkollën e fëmijës suaj dhe do të njiheni me ide se si të udhëhiqni për qëllimin e ndryshimit brenda komunitetit tuaj shkollor. Duke u bazuar në idetë e Paulo Freire, ky udhëzues synon të vërtetojë se të gjithë anëtarët e komunitetit shkollor janë pjesëmarrës aktivë në mësimin e tyre dhe të aftë të zhvillojnë aftësitë për të analizuar dhe transformuar realitetet e tyre sociale.

Falënderime



NYC Public Schools' Division of Multilingual Learners (Sektori për Nxënësit Shumëgjuhësh i Shkollave Publike të NYC-së)

The Division of Multilingual Learners (Sektori i Nxënësve Shumëgjuhësh) synon të sigurojë akses të barabartë në mësimdhënie rigoroze dhe pritshmëri të larta në një mjedis mikpritës që vlerëson identitetet racore, kulturore dhe gjuhësore të nxënësve shumëgjuhësh dhe imigrantë. Ne përpiqemi të sigurojmë që nxënësit të kenë një ndjenjë qëllimi dhe përkatësie në shkolla dhe të diplomohen të përgatitur për sukses në kolegji, në karrierë dhe në jetë.

Dr. Mirza Sánchez-Media

Shefe e Division of Multilingual Learners (Sektori për Nxënësit Shumëgjuhësh)

Charlene Clarke

Drejtoreshë Ekzekutive, Mbështetjet për Nxënësit Shumëgjuhësh dhe Imigrantë


UndocuTeacher

UndocuTeacher ofron mjete mësimore, shërbime këshillimi dhe zhvillim profesional, të krijuara për të përmirësuar përvojat e të nxënësve imigrantë, pa dokumente dhe shumëgjuhësh. Shërbimet e tyre lehtësojnë një qasje mësimdhënieje të përshtatshme në aspektin kulturor, duke u fokusuar në zhvillimin socio-emocional të nxënësve imigrantë me në qendër përvojat e tyre jetësore si pika të forta dhe vlera në procesin e të nxënësve. Division of Multilingual Learners (Sektori për Nxënësit Shumëgjuhësh) dëshiron të falënderojë UndocuTeacher për partneritetin në mendim dhe kontributet e tyre në krijimin e këtij udhëzuesi.

Emilia Fiallo

Themeluese e UndocuTeacher, ish-mësuese në
NYC Public Schools (Shkollat Publike të NYC)
Më parë pa dokumente

Kuptimi i Fuqisë dhe Aftësisë për të Vepruar



Fuqia

Fuqia është aftësia ose kapaciteti i individëve, grupeve ose institucioneve për të influencuar dhe ndikuar. Forma të ndryshme të fuqisë mund të përfshijnë fuqinë ekonomike, sociale, kulturore dhe politike, dhe ajo shfaqet përmes strukturave formale (si shkollat) dhe rrjeteve joformale (si marrëdhëniet sociale dhe praktikatat kulturore).



Si manifestohet fuqia nga familjet imigrante?

Pavarësisht rrugëtimit tuaj të emigrimit, ju keni forcën dhe aftësinë e lindur për të lundruar, për t'u përshtatur dhe për të ndikuar në çdo mjedis të ri. Fuqia juaj buron nga:

- Guximi dhe aftësia juaj për të ecur përpara çdo ditë pavarësisht sfidave.
- Vlerat tuaja kulturore, lidhjet me komunitetin dhe aftësia për të krijuar dhe përdorur rrjetet sociale.
- Aftësia juaj për të ndërtuar rrugën tuaj, për të aksesuar burime dhe për të kontribuar në strukturën shoqërore, ekonomike dhe kulturore të komuniteteve ku bëheni pjesë, falë përvojave dhe perspektivave tuaja unike.

Aftësia për të vepruar

Aftësia për të vepruar i referohet aftësisë të individëve për të vepruar në mënyrë të pavarur dhe për të bërë zgjedhje të lira. Ajo përfaqëson aftësinë për të ushtruar pushtet dhe ndikim mbi jetën dhe vendimet tuaja, edhe në situata ku barrierat dhe pengesat sistematike e bëjnë këtë një proces të vështirë.

Si e praktikojnë aftësinë për të vepruar familjet imigrante?

Familjet imigrante marrin vendime dhe ndërmarrin veprime që përputhen më së miri me nevojat dhe aspiratat e tyre, edhe kur përballen me sfida si pengesat gjuhësore, ndryshimet kulturore dhe kufizimet ligjore. Për familjet imigrante, aftësia për të vepruar përfshin:

- Autonomi: Aftësia për të bërë zgjedhje dhe marrë vendime për familjen tuaj.
- Fuqizim: Përdorimi i burimeve, njohurive dhe aftësive për të ndërmarrë veprime konkrete.
- Përgjegjësi: Të qenit përgjegjës për rezultatet e veprimeve dhe vendimeve të tyre.
- Rezistencë: Sfidimi dhe ndryshimi i strukturave të pushtetit që nuk i shërbejnë mirëqenies së familjes suaj.



Po tani, çfarë: Si mund ta përdor fuqinë dhe aftësinë për të vepruar për t'u bërë një advokues?



Hapat drejt advokimit për familjet imigrante:

- Hapi 1: Zgjeroni Njohuritë dhe Ndërgjegjësohuni
- Hapi 2: Ushtroni Aftësinë për të Vepruar përmes Angazhimit
- Hapi 3: Aksesoni Burime për t'u Fuqizuar

HAPI 1: ZGJERONI NJOHURITË DHE NDËRGJEGJËSOHUNI

SI FAMILJE SHUMËGJUHËSHE NË NYC PUBLIC SCHOOLS (SHKOLLAT PUBLIKE TË NYC-SË)

AKSESI

NYC Public Schools (Shkollat Publike të Nju-Jorkut) nuk pyesin dhe nuk e gjurmojnë statusin e imigracionit të nxënësve ose anëtarëve të familjes së tyre. Zotërimi i shtetësisë amerikane nuk përbën kusht për regjistrimin në asnjë shkollë publike të Nju-Jorkut.



Duhet të dini për çështjen

Plyler kundër Doe, të vitit 1982

Plyler kundër Doe është një vendim i Gjykatës së Lartë që garanton se të gjithë fëmijët, **pavarësisht nga statusi i tyre i imigracionit, kanë të drejtën për një arsimim publik falas nga kopshti deri në klasën 12.** Ky vendim u ndalon shkollave publike të refuzojnë regjistrimin e fëmijëve emigrantë pa dokumente, duke u njohur atyre të drejtën për arsimim.

KONFIDENCIALITETI

Shkollat nuk mund t'i ndajnë informacionet tuaja personale pa pëlqimin tuaj, përveç nëse kërkohet nga një urdhër i nënshkruar gjyqësor.

FERPA

Family Educational Rights and Privacy Act (Ligji për të Drejtat dhe Privatësinë Arsimore të Familjes) (FERPA)

Duhet të keni informacion për FERPA!

Sipas FERPA-s, informacionet e nxënësve dhe familjeve mbahen ligjërisht private. Shkollat nuk mund t'i ndajnë informacionet tuaja personale me agjenci të tjera, përfshirë ICE (Immigration and Customs Enforcement), pa pëlqimin tuaj, përveç nëse kërkohet nga një urdhër i nënshkruar gjyqësor.

Kjo do të thotë se të gjitha informacionet që ndani me shkollën tuaj mbeten konfidenciale, duke përfshirë:

- dokumentet e regjistrimit.
- informacionet e aplikimit në kolegji të fëmijës tuaj, si emrat, adresat dhe shumë të tjera. Informacionet e kontaktit në rast urgjence,
- duke përfshirë emrat dhe adresat.

HAPI 1: ZGJERONI NJOHURITË DHE NDËRGJEGJËSOHUNI

SI FAMILJE IMIGRANTE NË NYC PUBLIC SCHOOLS (SHKOLLAT PUBLIKE TË NYC-SË)

3 SHKOLLAT E SIGURTA

Shkolla të sigurta Zyrtarët e organeve ligjzbatuese jolokale, duke përfshirë Immigration and Customs Enforcement (ICE) (Zyra për Doganat dhe Imigracionin), nuk lejohen të hyjnë në shkolla, përveç rasteve kur kjo kërkohet ligjërisht dhe pas konsultimit me avokatët e NYC Public Schools (Shkollat Publike të Nju-Jorkut).



MBANI MEND:

MUND të paraqiteni në shkollën e fëmijës suaj pavarësisht statusit të imigracionit!



- Shkollat janë vende të sigurta për familjet imigrante.
- Shkollat NUK ju kërkojnë të paraqitni një mjet identifikimi të lëshuar nga një shtet ose SHBA-të për të hyrë në ambientet e tyre.
- Mund të sillni pasaportën, kartën e identitetit të lëshuar nga konsullata, kartën e identitetit të NYC-së (IDNYC), kartën me foto të identitetit të punonjësit, kartën me foto të asistencës publike ose kartën e identitetit të nxënësit për t'u identifikuar si mysafir ose vizitor.

HAPI 1: ZGJERONI NJOHURITË DHE NDËRGJEGJËSOHUNI SI FAMILJE SHUMËGJUHËSHE

QASJA SHUMËGJUHËSHE

NYC Public Schools
(Shkollat publike të Nju-
Jorkut) vlerësojnë
diversitetin kulturor dhe
gjuhësor të Familjeve dhe
nxënësve shumëgjuhësh
si pasuri për të gjitha
komunitetet shkollore.

SHKOLLAT PUBLIKE TË NJU-JORKUT JANË SHUMËGJUHËSHE

Gjatë vitit shkollor 2022-2023, **nxënësit që mësojnë anglishten (ELL) në shkollat publike të NYC-së komunikuan në 150 gjuhë të tjera përveç anglishtes.** Mbi 66% e nxënësve ELL flasin spanjisht, të pasuar nga nxënësit që flasin kinezisht, arabisht, rusisht, bengalisht, urduisht, kreolisht haitiane, uzbekisht, frëngjisht dhe ukrainisht.

Burimi: Raporti i DML-së mbi Demografinë
e ELL për vitin shkollor 2022-
23 në një vështrim të përgjithshëm

TERMS TO KNOW AS AN IMMIGRANT AND MULTILINGUAL PARENT:



- **Shumëgjuhësh** - i referohet përdorimit të shumë gjuhëve nga një individ ose brenda një komuniteti.
- **Anglishtja si gjuhë e re (English as a New Language - ENL)** është një program i krijuar për të mbështetur nxënësit e gjuhës angleze të zhvillojnë aftësitë e tyre në gjuhën angleze.
- **Nxënës i gjuhës angleze (English Language Learner - ELL)** është një nxënës i cili nuk ka anglishten gjuhë të parë dhe i cili ka nevojë për mbështetje shtesë në mënyrë që të arrijë të zotërojë gjuhën angleze.
- **Programe arsimore dygjuhëshe** - Këto programe, duke përfshirë arsimin dygjuhësh dhe arsimin kalimtar dygjuhësh, i ndihmojnë nxënësit të zotërojnë si anglishten, ashtu edhe gjuhën e tyre amtare. Programet dygjuhëshe përfshijnë mësimdhënie të dyja gjuhët, ndërsa arsimi dygjuhësh kalimtar synon një kalim gradual drejt anglishtes.

HAPI 1: ZGJERONI NJOHURITË DHE NDËRGJEGJËSOHUNI

SI FAMILJE SHUMËGJUHËSHE

AKSESI GJUHËSOR

Shkollat duhet të sigurojnë që familjet t'i marrin komunikimet e rëndësishme shkollare në gjuhën e tyre të preferuar, duke përfshirë përkthimin e dokumenteve dhe shërbime interpretimi.

Njihni të Drejtat Tuaja për Akses Gjuhësor

Komunikimi Në Gjuhën e Preferuar:

- Familjet kanë të drejtë të marrin informacion mbi edukimin e fëmijës së tyre në gjuhën e preferuar, duke përfshirë përkthimin e dokumenteve të rëndësishme dhe akses në shërbime interpretimi.

Raportet e Progresit:

- Prindërit kanë të drejtë të marrin rregullisht raporte për progresin e fëmijës së tyre në mësimin e anglishtes dhe në lëndë të tjera shkollare. Këto raporte duhet të komunikohen në gjuhën e tyre të preferuar.

ALTERNATIVAT E GJUHËS

Shkollat duhet të ofrojnë shërbime të anglishtes si gjuhë e re (ENL), si programe arsimore dygjuhëshe për të gjithë nxënësit që po zhvillojnë aftësitë e tyre në gjuhën angleze.

Njihni të Drejtat Tuaja mbi Alternativat Gjuhësore

Shërbime të Tjera Mbështetëse:

- Prindërit kanë të drejtë që fëmija i tyre të vlerësohet për njohurinë në anglisht dhe të marrë shërbime të përshtatshme të mbështetjes gjuhësore, si mësimi i anglishtes si gjuhë e re (ENL) dhe programe arsimore dygjuhëshe.

Zgjedhja e Programit

- Prindërit kanë të drejtë të zgjedhin nga programet e disponueshme të mbështetjes gjuhësore (p.sh. Program dygjuhësh, arsim dygjuhësh kalimtar, ENL) për fëmijën e tyre, si dhe të marrin informacion të hollësishëm rreth çdo alternative programi.

Pjesëmarrja në Aktivitetet Shkollare:

- Prindërit kanë të drejtë të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet dhe takimet shkollare në lidhje me arsimin e fëmijës së tyre, dhe t'u ofrohet ndihmë gjuhësore.

HAPI 1: ZGJERONI NJOHURITË DHE NDËRGJEGJËSOHUNI

AKSESI NË KOLEGJ DHE KARRIERË PËR FËMIJËT TUAJ

AKSESI NË KOLEGJ

Nxënësit pa dokumente
Mund të shkojnë në
kolegj pavarësisht
statusit

FAMILJET ME STATUS TË PËRZIER

Nxënësit e lindur në SHBA
mund të shkojnë në kolegj
edhe nëse prindërit e tyre
nuk kanë dokumente.

NDIHMJA FINANCIARE

Për nxënësit pa dokumente
ekzistojnë mbështetje financiare
për financimin e arsimit të tyre!

Facts for Undocumented Students:

- **Nxënësit pa dokumente nuk kanë të drejtë për ndihmë financiare federale**, duke përfshirë grantet, kreditë dhe programet studim-punë.
- **Nxënësit pa dokumente në Nju-Jork kanë mundësi të përfitojnë ndihmë financiare shtetërore përmes ligjit DREAM të shtetit të Nju-Jorkut**, i cili i lejon ata të aplikojnë për forma të ndryshme asistence, përfshirë:
 - Programi i Ndihmës për Tarifatat e Shkollimit (Tuition Assistance Program - TAP)
 - Bursa Excelsior: Mbulon tarifat e shkollimit për studentët e kualifikuar që ndjekin shkollat SUNY ose CUNY.
 - Çmimet e Përmirësuar të Shkollimit (Enhanced Tuition Awards – ETA): Ofron asistencë për tarifat e shkollimit, për nxënësit që ndjekin mësimet në kolegj private në Nju-Jork.
 - Për të aplikuar, nxënësit duhet të plotësojnë online aplikimin sipas ligjit DREAM të Nju-Jorkut dhe të përmbushin kriteret.
- **Nxënësit pa dokumente në Nju-Jork mund të kualifikohen për tarifat e shkollimit për rezidentët e shtetit nëse ndjekin studimet në kolegj dhe universitete publike dhe plotësojnë kritere të caktuara**, ndër të cilat:
 - Duhet të kenë ndjekur një shkollë të mesme të lartë në Nju-Jork për të paktën dy vjet dhe të jenë diplomuar në një shkollë të mesme të lartë në Nju-Jork, ose të kenë marrë një diplomë ekuivalente me shkollën e mesme (GED) të shtetit të Nju-Jorkut.
 - Duhet të regjistrohen në një kolegj ose universitet të shtetit të Nju-Jorkut brenda pesë vjetësh nga marrja e diplomës së shkollës së mesme të lartë ose e GED-it.
 - Duhet të dorëzojnë një deklaratë pranë kolegjit ose universitetit, ku pohojnë se do të aplikojnë për rezidencë ligjore sapo të kualifikohen për këtë.

For U.S-born children in mixed-status families:

- **Kualifikimi për Ndihmë Federale:** Nëse nxënësi është shtetas i SHBA-së ose joshtetas i kualifikuar, ai mund të plotësojë Aplikimin Falas për Ndihmën Federale për Nxënësit (FAFSA), i cili është një formular që përdoret nga nxënësit për të aplikuar për ndihmë financiare federale pavarësisht statusit të imigracionit të prindërve të tyre.
- Familjet inkurajohen të vizitojnë <https://studentaid.gov/h/apply-for-aid/fafsa> për informacion të përditësuar dhe të kontaktojnë këshilltarin e kolegjit të fëmijës së tyre për mbështetje.

HAPI 1: ZGJERONI NJOHURITË DHE NDËRGJEGJËSOHUNI

FAMILJET NË STREHIM TË PËRKOHSHËM

Nxënësit në strehim të përkohshëm përfshijnë të rinjtë dhe familjet që:

- Jetojnë së bashku me të tjerë (miq ose të afërm), për shkak se nuk mund të gjejnë ose përballojnë një banesë
- Jetojnë në një strehë ose strehë kalimtare,
- Jetojnë në një hotel/motel,
- Jetojnë në një makinë, autobus ose tren,
- Jetojnë në një park ose vend publik, ose
- Jetojnë në një ndërtesë të braktisur
- Si pjesë e kësaj kategorie konsiderohen edhe të rinjtë e pashoqëruar dhe që nuk janë nën kujdestarinë e një prindi ose kujdestari, duke përfshirë ata që:
 - kanë ikur nga shtëpia;
 - janë përzënë nga shtëpitë e tyre ose
 - janë braktisur nga prindërit.

Burimi: NYC Public Schools (Shkollat Publike të NYC): Nxënësit në strehim të përkohshëm

LIGJI I MCKINNEY-VENTO

Nxënësit në strehim të përkohshëm gëzojnë të drejta, ndër të cilat të drejtën për arsim falas, të drejtën për transport falas dhe të tjera.

Nxënësit dhe familjet që mbulohen nga Ligji McKinney-Vento për shkak të rrethanave të tyre aktuale të strehimit të përkohshëm kanë të drejtën për mbështetjet e mëposhtme:

- Arsim publik falas.
- Regjistrim i menjëhershëm në shkollën afër zonës së banimit, nëse ka vende të lira.
- Frekuentimi i shkollës pavarësisht nga koha që kanë jetuar në vendndodhjen e tyre aktuale.
- Të qëndrojnë në shkollën e tyre të origjinës (shkolla që kanë ndjekur para se të mbeten pa banim ose shkolla e fundit që kanë ndjekur) ose të zgjedhin të ndjekin shkollën afër zonës së banimit.
- Shërbime transporti për të shkuar dhe për t'u kthyer nga shkolla.
- Të mos u refuzohet regjistrimi i menjëhershëm në shkollë vetëm për shkak të situatës së tyre ose mungesës së dokumentacionit të regjistrimit.
- Të mos veçohen nga programi i rregullt shkollor për shkak se janë të pastrehë.
- Të marrin vakte shkollore falas.

Burimi: NYC Public Schools (Shkollat Publike të NYC): Nxënësit në strehim të përkohshëm

HAPI 1: ZGJERONI NJOHURITË DHE NDËRGJEGJËSOHUNI

FAMILJET NË STREHIM TË PËRKOHSHËM



FAMILJET PA DOKUMENTE

Familjet e imigrantëve pa dokumente mund të përfitojnë nga shumë shërbime qytetare, pavarësisht nga statusi i tyre.

Pavarësisht statusit të imigracionit, familjet mund të përfitojnë:

- Sigurim shëndetësor me kosto të ulët ose
- falas Mëngjes ose drekë në shkollë falas
- Kartë identiteti falas e qytetit përmes
- IDNYC Ushqim nga depo ushqimesh dhe kuzhina komunitare
- Programet përforcuese verore të Nju-Jorkut

Burimi: Udhëzues burimor për nxënësit në strehim të përkohshëm



FAMILY WELCOME CENTERS (QENDRAT E MIRËSEARDHJES PËR FAMILJET)

Qendrat e mirëseardhjes, punonjësit socialë në shkolla dhe Burimet online ofrojnë ndihmë lokale lidhur me aksesimin e mbështetjes.

BURIME KYÇE:

- Qendrat e mirëpritjes për regjistrimin:
 - [https:// www.schools.nyc.gov/enrollment-ent/enrollment- help/ family- welcome- centers](https://www.schools.nyc.gov/enrollment-ent/enrollment-help/family-welcome-centers)
- Kontaktoni **punonjësin social të shkollës** për mbështetje në aksesimin e burimeve kyçe lidhur me strehimin, përfitimet publike, transportin dhe mundësinë e aksesit në ushqim.
- Udhëzuesi Kryesor për Nxënësit në Strehim të Përkohshëm:
 - sth.cityofnewyork.us/

HAPI 2: USHTRONI AFTËSINË PËR TË VEPRUAR PËRMES ANGAZHIMIT

- STRATEGJI PËR KOMUNIKIM EFEKTIV ME EDUKATORËT
- MUNDËSITË PËR PËRFSHIRJEN E PRINDËRVE DHE FAMILJEVE NË PROCESET VENDIMMARRËSE TË SHKOLLAVE
- NXITJA E KOMPETENCËS KULTURORE DHE PËRFSHIRJES NË SHKOLLËN TUAJ

Familjet, arsimtarët dhe anëtarët e komunitetit janë të gjithë partnerë thelbësorë në nxitjen e suksesit të nxënësit.

Në qendër të këtij bashkëpunimi është nxënësi, i cili përfiton nga një familje e informuar, e angazhuar dhe e pranishme.

Angazhimi në shkollë merr forma të ndryshme për çdo familje. Përdorni aftësinë për të vepruar për të përcaktuar mënyrat më të mira të përfshirjes që funksionojnë për ju dhe fëmijën tuaj.



Praktika 1

Qëndroni të angazhuar dhe mbani komunikim të rregullt me shkollën dhe mësuesit e fëmijës suaj.

Praktika 2 Jini të pranishëm dhe të dukshëm në shkollën e fëmijës suaj.



Praktika 3

Ofroni reagime dhe ndani mendime me shkollën e fëmijës suaj.

Mbani mend se statusi juaj i imigracionit dhe aftësitë gjuhësore nuk ju pengojnë të angazhoheni në shkollën e fëmijës suaj!

HAPI 2: USHTRONI AFTËSINË PËR TË VEPRUAR PËRMES ANGAZHIMIT

Përditësoni Informacionin Tuaj të Kontaktit

Sigurohuni që informacioni i kontaktit për raste urgjente të jetë aktual duke përditësuar të dhënat në zyrën e shkollës së fëmijës suaj.

Bisedoni me Koordinatorin e Prindërve

Lidhuni me koordinatorin e prindërve në shkollën e fëmijës suaj për udhëzime dhe informacion mbi programet, burimet, trajnimet, aktivitetet dhe mënyrat e përfshirjes.

Llogaria në New York City Schools (Shkollat Publike të Qytetit të Nju Jorkut)

Aplikacioni NYC Schools Account (NYCSA) ju ndihmon të ndiqni arsimin e fëmijës suaj duke ofruar akses te notat, pjesëmarrja në mësim, orari dhe shumë të tjera.

Praktika 1: Qëndroni të angazhuar dhe mbani komunikim të rregullt me shkollën dhe mësuesit e fëmijës suaj



Komunikoni me Mësuesit

Mësuesit dhe stafi i shkollës do t'ju kontaktojnë përmes telefonatave, mesazheve ose emaileve. Sigurohuni që komunikimi të jetë në gjuhën tuaj. Kontaktoni shkollën nëse ju nevojitet mbështetje me përkthimin.

BURIMET:

- Në rast se ju nevojitet të gjeni informacionin e kontaktit për stafin specifik të shkollës, përfshirë koordinatorin e prindërve të shkollës së fëmijës suaj, vizitoni <https://schoolsearch.schools.nyc/> dhe shkruani emrin e shkollës.
- Sigurohuni që të keni llogari në New York City Schools (Shkollat Publike të Qytetit të Nju Jorkut) Shkoni te <https://www.schoolsaccount.nyc/> për të hapur një llogari në gjuhën tuaj.

KËSHILLË:

Kontaktoni një mik! Nëse keni vendosur të gjitha urat e komunikimit me shkollën tuaj, tregojini një miku që të ndjekë të njëjtat hapa për të qëndruar të informuar si komunitet!

HAPI 2: USHTRONI AFTËSINË PËR TË VEPRUAR PËRMES ANGAZHIMIT

Merrni Pjesë në Takimet dhe Ngjarjet Shkollore

Angazhohuni në ngjarjet shkollore, si ekskursione, ndihmë në klasë ose panaire shkollore, për të treguar pjesëmarrjen, zërin dhe mbështetjen tuaj.

Përfshihuni në Grupe dhe Komitete të Drejtura nga Prindërit

Bëhuni anëtar aktiv i Parent-Teacher Association (Shoqata e Prindërve dhe Mësuesve) ose i komiteteve të tjera të shkollës për të kontribuar në vendimet dhe aktivitetet e shkollës, pavarësisht aftësive tuaja gjuhësore.

Merrni Pjesë në Takimet me Prindërv dhe Mësuesve

Merrni pjesë rregullisht në takimet me mësuesit e fëmijës suaj për të qëndruar të informuar mbi përparimin e tyre dhe për të trajtuar çdo shqetësim. Shkolla duhet të ofrojë shërbime përkthimi dhe interpretimi.

Praktika 2: Jini të pranishëm dhe të dukshëm në shkollën e fëmijës suaj.



Vizitoni Rregullisht Shkollën

Bëni vizita periodike në shkollë për të ndërvepruar me stafin dhe mësuesit, duke shfaqur interesin tuaj në vazhdueshëm për arsimimin dhe mirëqenien e fëmijës suaj.

BURIMET:

- Mësoni data të rëndësishme të shkollës publike të NYC në kalendarin e shkollës: <https://www.schools.nyc.gov/calendar>

Këshillë: A ua keni bërë këto pyetje mësuesve të fëmijës suaj?

- Çfarë pritet të mësojë fëmija im në këtë nivel të klase dhe çfarë projektsh kryesore do të realizojë?
- Si do ta kuptoj nëse fëmija im po arrin pritshmëritë për gjuhën dhe nivelin e klasës gjatë gjithë vitit?
- Në çfarë gjërash fëmija im ka sukses dhe në cilat has vështirësi?
- Çfarë burimesh disponohen nëse fëmija im ka nevojë për ndihmë shtesë ose dëshiron të mësojë më shumë jashtë klasës?
- Si mund t'ju kontaktoj nëse kam ndonjë pyetje?

HAPI 2: USHTRONI AFTËSINË PËR TË VEPRUAR PËRMES ANGAZHIMIT

Këndvështrimi Juaj Ka Rëndësi

NYC Public Schools
(Shkollat Publike të NYC)
funksionojnë më mirë kur
prindërit Imigrantë
angazhohen dhe ndajnë
një këndvështrim unik që
ndihmon në formësimin e
programeve dhe sistemeve
të mbështetjes për
nxënësit Imigrantë.

Komunikoni rreth nevojave të fëmijës suaj

Njoftoni mësuesit dhe stafin
e shkollës për çdo nevojë
specifike, stil të mësimi ose
faktor kulturor që mund t'i
ndihmojë ata të ofrojnë
mbështetje më efektive
për fëmijën tuaj.

Praktika 3: Ofroni reagime dhe ndani mendime me shkollën e fëmijës suaj



Merrni pjesë në anketat dhe formularët e vlerësimit të shkollës:

Pjesëmarrja në çdo anketë
ose mundësi për të dhënë
reagime të ofruar nga
shkolla ju jep mundësinë
të shprehni mendimet
dhe sugjerimet tuaja.

Krijoni hapësirën tuaj

Nëse shkolla juaj nuk po përdor
burimet për të mbështetur
nevojat tuaja gjuhësore ose për
të lehtësuar pjesëmarrjen tuaj,
krijoni një rrjet mbështetës me
prindër dhe mësues të tjerë
të gatshëm të kërkojnë
ndryshime, për të siguruar
që zëri i familjeve imigrante
të dëgjohet dhe të merret
në konsideratë.

BURIMET:

- Përfshihuni aty ku nevojitet këndvështrimi juaj:
 - Për të advokuar për nxënësit dhe familjet, bëhuni pjesë e një shoqate prindërishe:
<https://www.schools.nyc.gov/get-involved/families/parent-associations>
 - Për të promovuar përfshirjen dhe diversitetin, bëhuni pjesë e një këshilli për mirëqenien e në shkollë:
<https://www.schools.nyc.gov/get-involved/families/school-wellness-councils>

KESHILLE:

Nëse vëreni diçka në shkollën tuaj që dëshironi të ndryshoni, identifikoni një bashkëpunëtor ose anëtar të stafit që mund të ndihmojë. Ndajini shqetësimet me të, ndiqni nga afër situatën dhe qëndroni të përkushtuar për ta zgjidhur çështjen së bashku, si një ekip i shkollës.

HAPI 3: AKSESONI BURIME PËR T'U FUQIZUAR

SHËRBIMET E AKSESIT GJUHËSOR

NYC Public Schools (Shkollat Publike NYC) flasin gjuhën tuaj! Familjet mund të kërkojnë shërbime gjuhësore. Mësoni më shumë në: schools.nyc.gov/school-life/school-environment/hello



PARENT UNIVERSITY (UNIVERSITETI PËR PRINDËRIT) NGA NYC PUBLIC SCHOOLS (SHKOLLAT PUBLIKE TË NYC)

Parent University (Universiteti për Prindërit) synon të edukojë dhe të aftësojë familjet si partnerë, advokues dhe edukatorë të përjetshëm në arsimin e fëmijëve të tyre, përmes kurseve, burimeve, ngjarjeve dhe aktiviteteve falas. Regjistrohuni në: parentu.schools.nyc



ORGANIZATAT ME BAZË NË KOMUNITET

Organizata komunitare që ndihmojnë nxënësit shumëgjuhësh dhe imigrantë: bit.ly/DMLCBO



MËSONI ANGLISHT FALAS

We Speak NYC (WSNYC) (Ne flasim NYC) është programi falas i qytetit për të mësuar gjuhën angleze dhe për të zhvilluar biseda për të rriturit, i krijuar dhe administruar nga Mayor's Office of Immigrant Affairs (Zyra e Kryetarit të Bashkisë për Çështjet e Imigrantëve) (MOIA). Vizitoni: nyc.gov/wespeaknyc



MERRNI NJË MJET IDENTIFIKIMI

Karta IDNYC është një dokument i aksesueshëm dhe i sigurt që ju mundëson të përdorni shërbimet e qytetit dhe të hyni në ndërtesat e qytetit që ofrojnë shërbime për publikun. Vizitoni: nyc.gov/site/idnyc/index.page

Imigrantët pa dokumente që janë banorë të shtetit të Nju-Jorkut mund të aplikojnë për leje drejtimi standarde ose për kartë identiteti për jodrejtues mjeti. Vizitoni: dmv.ny.gov/



NDIHMË LIGJORE PËR ÇËSHJET E IMIGRACIONIT

Qyteti i Nju-Jorkut ofron ndihmë ligjore falas dhe të sigurt për çështjet e imigracionit përmes organizatave të besueshme komunitare në vende të ndryshme, duke përfshirë institucionet shëndetësore, shkollat dhe bibliotekat. Shërbimet ofrohen në gjuhën tuaj, pavarësisht nga statusi juaj i imigracionit. Telefononi Immigration Legal Support Hotline (Linja Falas e Mbështetjes Ligjore për Çështjet e Imigracionit) të MOIA-së në numrin 800-354-0365 ose 311 dhe thoni "ActionNYC", nga ora 9:00 deri në 18:00, e hënë deri të premte.



NJË MODEL VIZUAL I ANGAZHIMIT TË FAMILJES

Familjet imigrante dhe shumëgjuhëshe kanë fuqinë dhe aftësinë për të vepruar për të sjellë ndryshime pozitive në shkollat e fëmijëve të tyre duke shfrytëzuar njohurinë për të drejtat dhe burimet në dispozicion të tyre. Duke kuptuar të drejtat tuaja dhe duke shfrytëzuar burimet që kanë në dispozicion, familjet mund të udhëheqin me siguri iniciativat për ndryshim. Kjo siguron që, kur të vijë koha të kërkon përmirësime në shkollën e fëmijës suaj, të mund ta bëni këtë me vetëbesim dhe njohuri, pavarësisht pengesave gjuhësore apo statusit të imigracionit. Shkollat duhet të jenë vende ku të gjitha familjet ndihen se i përkasin dhe janë të fuqizuara për të sjellë ndryshime pozitive.



FLETË PUNE PËR SUKSESIN NË ANGAZHIMIN E FAMILJES

Organizohuni duke plotësuar këtë fletë pune, e krijuar për t'ju mbështetur në përdorimin e burimeve, njohurive dhe mjeteve të nevojshme që të ndiheni të sigurt kur të ngrini zërin si pjesë e komunitetit të shkollës.

Emri i shkollës: _____

Informacione të rëndësishme për shkollën që duhet t'i dini:

- ☐ Emri i koordinatori të prindërve i shkollës: _____
- ☐ Informacionet e kontaktit të koordinatori të prindërve: _____
- ☐ Emri i koordinatori ose mësuesit të ENL-së: _____
- ☐ Informacionet e kontaktit të koordinatori ose mësuesit të ENL-së: _____
- ☐ Emri dhe numri i telefonit i një prindi dhe i një shoku/shoqeje nga shkolla: _____


Lista e kontrollit për detyra të rëndësishme gjatë vitit shkollor

- | | |
|---|---|
| ☐ Të përditësoj informacionet e mia të kontaktit në zyrën kryesore | ☐ Të lidhem me të paktën një nga mësuesit e fëmijës tim |
| ☐ Të krijoj një llogari në NYC Schools Account | ☐ Të marr pjesë në një aktivitet të shkollës për të mbështetur fëmijën tim (performancë, prezantim ose lojë) |
| ☐ Të marr komunikimet nga shkolla në gjuhën time (email, mesazh ose telefonatë) | ☐ Të bëj një miqësi të re me një prind me të shkuar të ngjashme |
| ☐ Të prezantohem te koordinatori i prindërve | ☐ Të marr pjesë në takimin e vjeshtës mes prindërve dhe mësuesve |
| ☐ Të marr pjesë të paktën në një aktivitet me prindërit për të takuar mësuesit në fillim të vitit shkollor | ☐ Të bëj komente për shkollën në një anketë të paktën një herë në vit |
| ☐ Të marr pjesë në konferencën mes prindërve dhe mësuesve në vjeshtë | |
| ☐ Të angazhohen në një shoqatë ose komitet të udhëhequr nga prindërit | |

Organizatrat komunitare

- ☐ Shërbimet e imigracionit: _____
- ☐ Mbështetje për strehim: _____
- ☐ Kisha lokale: _____
- ☐ Mbështetje për shëndetin mendor: _____

Raste Studimore dhe Histori Suksesi



FAMILJA FIALLO

- Ne jemi një familje imigrante nga
- Ekuadori. Kemi pasur 2 fëmijë në NYC
- Public Schools (Shkollat Publike të NYC-së). Flasim spanjisht.

Sfidat me të cilat jemi përballur:

Nuk e dinim që mund të kishim akses në shkollën e fëmijëve tanë dhe shpesh nuk merrnim pjesë në takimet prindër-mësues. Ndihehim të shkëputur nga shkolla dhe kur erdhi koha që vajzat të aplikonin për kolegji, nuk mund t'i ndihmonim sepse nuk e dinim me kë të bisedonim në shkollë.

Zgjidhjet për sfidat tona

Këshilluesi i kolegjit të fëmijës sonë zbuloi pasiguritë tona në lidhje me kolegjin kur vajza jonë kërkoi ndihmë. Ne takuam këshilluesin kur vajza jonë fitoi një bursë për të filluar karrierën e saj në kolegji. Nuk e dinim që studentët pa dokumente kishin opsione.

Pikat tona të forta

- Besimi
- Dashuria për fëmijët tanë
- Martesa jonë
- Dashuria për gatimin!

Hobet tona


- Piknik çdo të premte
- në park Ndeshje futbollit në fundjavë

**Mësimi
i nxjerrë**



Familja Fiallo nuk kishte pse të ndante statusin e saj të imigracionit për të marrë mbështetje nga këshilluesi i kolegjit. Çdo shkollë duhet të sigurojë që të gjithë prindërit të informohen për burimet e disponueshme në gjuhën e tyre. Familja Fiallo krijoi një precedent, duke e bërë këshilluesin e kolegjit të vetëdijshëm për praninë e më shumë familjeve pa dokumente dhe me status të përzier në situata të ngjashme. Familja Fiallo duhet të festojë advokimin e saj, gjë që do të sigurojë që këto burime të ndahen me të gjitha familjet në të ardhmen.

Raste Studimore dhe Histori Suksesi



FAMILJA BHUIYAN-MORALES

- Ne jemi një familje me status të përzier, me origjinë nga Azia Juglindore dhe Meksika.
- Ne kemi 2 fëmijë në NYC Public Schools (Shkollat Publike të NYC) Flasim bengalisht, spanjisht dhe anglisht

Sfidat me të cilat jemi përballur:

Me fëmijën tonë më të madh, shkolla kishte vështirësi të komunikonte me ne në mënyrë proaktive. Shqetësimi im më i madh ishin keqkuptimet kulturore që fëmija im përjetoj në atë shkollë. Organizuam një takim me drejtuesit e shkollës, këshilluesin, mësuesin, mësuesin e shkrimit dhe leximit dhe terapistin e artit. Unë paraqita një listë shqetësimesh dhe sugjerimet e mia, duke advokuar për atë që e dija se do të funksiononte më mirë për fëmijën tim. Me ndihmën e këshilluesit, hartuam një plan. Plani funksionoi, dhe pamë një përmirësim të dukshëm në sjelljen e djalit tim, megjithatë besimi im te shkolla u thyë.

Pikat tona të forta

- Të qenit transparentë dhe të ndershëm në komunikimin me njëri-tjetrin. Marrja e vendimeve bashkërisht si familje.

Hobët tona

- Udhëtimet
- Provimi i ushqimeve të ndryshme
- Lojërat e tavolinës dhe loja me enigma
- Shikimi i filmave së bashku
- Kërcimi për të larguar stresin me muzikë


Zgjidhjet për sfidat tona

Këshilluesi i shkollës na ndihmoi të kuptojmë opsionet tona. Si familje, vendosëm të hulumtojmë më thellë rreth shkollave dhe të pranojmë se ndonjëherë një shkollë e caktuar mund të mos jetë e përshtatshme për fëmijën tonë. Kuptuam se është e rëndësishme të dimë kur është koha për t'u transferuar në një shkollë ku fëmija ynë do të kuptohet dhe mbështetet. Tani e di se kam fuqinë të shpreh mendimin tim. Kam mësuar të dokumentoj të gjitha bisedat dhe ndërveprimet dhe të vij i përgatitur në takime me prova dhe zgjidhje.

**Mësimi
i nxjerrë**



Familjes Bhuiyan-Morales iu desh të merrte vendime të vështira. Është thelbësore që prindërit ti ngrenë shqetësimet e tyre në shkollë, duke siguruar përgjegjshmëri nga të dyja palët. Nëse keni nevojë për mbështetje gjuhësore gjatë takimeve, shkolla është e detyruar ta ofrojë atë. Si familje imigrante, keni të drejtën të diskutoni përparimin akademik të fëmijës suaj me shkollën pa frikë nga ndonjë hakmarrje. Është gjithashtu e rëndësishme të kërkonti ndihmë nga ekspertët, nëse ju nevojitet shumë informacion. Familja Bhuiyan-Morales gjeti mbështetje duke u konsultuar me një psikolog fëmijësh dhe një terapist për shëndetin mendor. Ata janë mbrojtësit dhe përkrahësit më të mirë për fëmijët e tyre.



Letër drejtuar të gjitha familjeve imigrante

Nuk ka asnjë udhëzues që mund t'i mësojë prindërit si të jenë të fortë dhe të qëndrueshëm përballë ndryshimeve të mëdha që sjell migrimi në jetën e një familjeje. Nuk ka një udhërrëfyes hap-pas-hapi që të mëson si të përballesh në një vend të ri, larg familjaritetit të shtëpisë, ndërkohë që rrit fëmijët, ruan vendin e punës dhe mëson një kulturë e një gjuhë të re. Shumë nga këto përvoja të reja do të jenë sfiduese, por, si shumë herë më parë, edhe këto sfida do t'i kapërceni dhe do vijnë ditë më të mira. Të jesh prind imigrant në qytetin e Nju-Jorkut nuk është e lehtë, por nuk duhet të jetë një rrugëtim i vetmuar. Një pjesë e fuqisë që të gjithë imigrantët e mbartin në vetvete është aftësia për të ndërtuar komunitete dhe rrjete mbështetjeje që sigurojnë mirëqenien e secilit.

Komuniteti është çelësi për të kapërcyer sfidat. Bashkimi ynë në komunitet është fuqia jonë.

Ndërsa çdo ditë mund të lindin sfida të reja, kujtoni se ju keni fuqinë dhe mundësinë të mbështeteni te vetja, te komuniteti juaj dhe te burimet që keni, për të krijuar jetën për të cilën keni ëndërruar në këtë vend të ri që tashmë është shtëpia juaj. NYC Public Schools (Shkollat publike të NYC) janë të përkushtuara të jenë vende të sigurt për familjet imigrante – hapësira ku ju vlerësoheni si anëtarë të rëndësishëm, duke sjellë me vete gjuhë, perspektiva, kultura dhe vlera të ndryshme. Tani është momenti që ju, si prind apo kujdestar, të siguronit që shkolla e fëmijës suaj të punojë për arritjen e këtij vizioni të përbashkët.

